



This programme is funded  
by the European Union



## THIRRJE PËR POZICIONIN “EKSPERT KOMUNIKIMI”

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare kërkon të shprehni interesin tuaj për pozicionin ekspert komunikimi.

Kjo thirrje kryhet në kuadrin e zbatimit të projektit “*Ngritja e një platforme të organizatave jofitimprurëse dhe rrjeteve për një zbatim më të mirë të standardeve ndërkombëtare mbi barazinë gjinore dhe kundër dhunës në familje në Shqipëri*”; Ky projekt financohet nga Komisioni Evropian dhe zbatohet me mbështetjen e UN Women.

### TERMAT E REFERENCES

**Projekti:** “Ngritja e një platforme të organizatave jofitimprurëse dhe rrjeteve për një zbatim më të mirë të standardeve ndërkombëtare mbi barazinë gjinore dhe kundër dhunës në familje në Shqipëri”;

#### **Aktiviteti nr.4: Përdorimi i medias sociale si mjet komunikimi;**

**Objektivi:** Ekspertja e komunikimit do të ofrojë ekspertizë profesionale komunikimi të rezultateve të projektit “Ngritja e një platforme të organizatave jofitimprurëse dhe rrjeteve për një zbatim më të mirë të standardeve ndërkombëtare mbi barazinë gjinore dhe kundër dhunës në familje në Shqipëri”.

#### **Kandidati/ja duhet të përmbushë sa vijon:**

- Të ketë përfunduar studimet e larta për gazetari, shkenca shoqërore ose degë të tjera të lidhura me to;
- Të ketë përvojë në fushën e medias.
- Preferohen kandidatë me përvoja të mëparshme pune ose angazhimi me OJF ose rrjete që punojnë në fushën e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;
- Preferohen kandidatë me përvoja të mëparshme të komunikimit të rezultateve të shoqërisë civile në media dhe median sociale;
- Preferohen kandidatë që njohin shumë mirë gjuhën angleze.

## DETYRAT

Detyrat dhe përgjegjësitë e ekspertës së komunikimit janë:

- Të përgatisë një plan/strategji komunikimi të platformës së OJF-ve dhe rrjeteve dhe ta zbatojë atë gjatë zbatimit të projektit;
  - Të bëjë publike rezultatet e projektit dhe të jetë kreativ në përdorimin e metodave të komunikimit;
  - Të formulojë mesazhe që arrijnë një numër të lartë përfituesish;
  - Të bëjë publike mbështetësit e projektit në komunikimet e ndryshme në median sociale;
  - Të ketë një bashkëpunim të ngushtë me koordinatoren teknike të projektit dhe sekretariatit e platformës së OJF-ve dhe rrjeteve;
  - Të kontribuojë në përgatitjen dhe publikimin e deklaratave për shtyp, raporteve të shkurtra, mesazheve dhe materialeve promovuese të projektit si edhe materialeve të tjera që do të përgatiten në bashkëpunim me anëtarë të platformës së OJF-ve dhe rrjeteve;
  - Të marrë pjesë në çdo aktivitet të projektit me qëllim publikimin e informacioneve dhe/ose mesazheve nga aktivitetet.
- **Eksperti/ekspertja e komunikimit do të angazhohet për 40 ditë pune gjatë gjithë kohëzgjatjes së zbatimit të projektit nga data 1 Dhjetor 2017-31 Dhjetor 2019;**
- 1) **Nëse jeni dakord me termat e referencës ju lutem na dërgoni një email pranimi si edhe një CV.**
  - 2) **Jeni të lutur të dërgoni ofertën tuaj financiare në lek për ditë pune;**

**CV dhe oferta juaj financiare duhet dorëzuar deri në datën 10.12.2017, në [avokatore2@yahoo.com](mailto:avokatore2@yahoo.com).**

## PROCEDURA E VLERËSIMIT

Eksperti/ja do të vlerësohet bazuar në një analizë kumulative duke konsideruar kombinimin e kualifikimeve të kandidatit/es dhe propozimit financiar.

Kritere teknike - 70% e vlerësimit në total – max i pikëve: 70

Kriteri A: Arsimi – max i pikëve: 20

Kriteri B: Eksperienca në fushën e komunikimit – max i pikëve: 30

Kriteri C: Përvoja në OJF dhe/ose rrjete të OJF-ve– max i pikëve: 20

**Kriteri financiar** - 30% i vlerësimit në total – max i pikëve: 30.